
Gëzim Ajgeraj

DITA ME TONIN
(Poemë)

Zvicër, 2006

Mirëmëngjesi, mirëmëngjesi
në dritare plot shkëlqim
përsëndet dielli me rreze
e zgjon Tonin plot gëzim

E përçafon nëpër faqe
lehtë e lehtë plot ledhatim
zgjohet Toni hap dritaren
e mbush dhomën plot freskim

Cicërojnë zogjtë në lisa
qiellit lirshëm fluturojnë
këngës tyre mbushullon dita
sa shumë Tonin e Gëzojnë

Lan fytyrën me nxitim
edhe dhëmbët plot shkëlqim
vishet mbathet i gëzuar
me këngë në gojë ai është zgjuar

Ty të ka mëma bilbil
je këngëtari më i mirë
gati është edhe mëngjesi
thërret mamaja në kuzhinë

Mirëmëngjesi, mirëmëngjesi
i hidhet mamasë në përqafim
pastaj Toni e ha mëngjesin
faqekuqi plot gëzim

Qumësht të ngrohtë edhe mjaltë
ka sjellë mamaja në pjatë
është e ëmbël plot shëndet
fytit Tonit lehtë rrëshqet

E gëzon dhe shumë mamanë
ai mëngjesin kur e ha
uron nëna plot shëndet
të rritet Toni sa më shpejt

Çantën me libra e fletore
niset Toni për në shkollë
i uron mamaja sukses
për çdo ditë nga një pesë

Ikën Toni me nxitim
drejt shkollës fluturim
për detyrat s'e ka dert
i ka bërë të gjitha vetë

Lexon bukur në abetare
as gabime nuk bën fare
të gjitha shkronjat i ka mësuar
pesë mësuesi i ka dhuruar

Numëron bukur në matematikë
mbledh e zbret pa gabim
dhe shumëzimin tash mëson mësuesin fort e disponon

Edhe arti mirë i shkon
diellin bukur di ta vizatojë
krahëhapur i pret rrezet
se pa to s'mund kush të rrojë

Në fizkulturë është më i miri
akrobat është më trimi
për futboll kush s'ia kalon
për çdo ditë nga pak ushtron

Luan top për mrekulli
kapiten i klasës së tij
sa herë gol ai shënon
shënon Toni, klasa jehon

Mësuesi shumë atë e do
notat pesa ia dhuron
më i miri është në shkollë
dhe në sjellje shembullor

Ka shumë shoqe edhe shokë
mësojnë së bashku të gjithë tok
në detyra u ndihmon
prandaj të gjithë e respektojnë

Kthehet plot pesa në shtëpi
i gëzon prindërit e tij
mami e babi i premtojnë
në fakultet do ta shkollojnë

E hanë drekën plot gëzim
një orë gjumë për pushim
dhe detyrat i mbaron
pastaj në lojë me shokët shkon

Luajnë me top dhe këndojnë
kohën e lirë e kalojnë
lakmi i ka dhe xhaxhi Gon
në kodër të fshatit kur i shikon

Ia kam thotë lakmi
lojës tuaj plot gëzim
mbi të gjithëve djalosh Tonit
është i sjellshëm plot guxim

Ora pesë iku pasditja
në mes shokëve dikush thotë
sërish nesër në këtë kohë
mbaroi loja dhe për sot

Ikën vogëlushët një nga një
para mbrëmjes në shtëpi
koha e darkës pranë tryezës
Toni i lodhur e shuan urinë

Sërish librat i shfleton
dhe mësimet i lexon
gjithë detyrat i mbaron
pranë babait ulet pushon

Bisedon dhe me babanë
njëri tjetrin e dëgjon
e ka në qejf shumë mjekësinë
të sëmurëve t'u ndihmojë

Natën e mirë, natën e mirë
i thotë babit e mamasë
i lanë këmbët e fytyrën
mbi krevat nis të gërgasë

Shumë shpejt e zë gjumi
fle i qetë si pëllumbi
sa herë mamaja e mbulon
edhe faqeve e lëmon

Fli i qetë biri im
m'u bëfsh mamasë djalë trim
i këndon një ninullë
Vogëlush Toni fle në gjumë

6.4.2006

Gëzim AJGERAJ, u lind në Malësi të Vërrinit më 6 gusht të vitit 1967. Ka botuar këta libra: **1. "Klithmë malli"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1997; **2. "Ëndrra për paraajsë"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **3. "Qiellet po digjem"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **4. "Flakë në plagë"**, poezi, „Rilindja“, Prishtinë, 1998; **5. "Kënga e babait"**, poezi për fëmijë, „Apolonia“, Prishtinë, 1998; **6. "Urti popullorë të Vërrinit" 1** (bashkautorësi), „Apolonia“, Prishtinë, 1998; **7. "Mallëgjimi"**, poezi, „Rilindja“, 2000; **8. "Balada e Vërrinit"**, Kl. „F. S. Noli“, Prizren, 2001; **9. "Rruga e lirisë"**, dramë, „Meshari“ Prishtinë, 2001; **10. "Rruga e lirisë" - Intervistë me Zafir Berishën**, botoi Asociacioni i Veteranëve të ish-UÇK-së – Prizren, 2002; **11. "Atdheu në trastë"**, cikël me poezi, botoi revista letrare "Jeta e re" nr. 4, korrik-gusht 2002, viti LIV. Prishtinë; **12. "Pëllumbat e lirisë"**, novelë për fëmijë, Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2004; **13. "Ditët e bardha"**, novelë për fëmijë, Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2004; **14. "Atdheu i copëtuar"**, cikël me poezi, në librin "**Pikoi molla gjak**" (Lirikë me motive arvanitase), botoi MKRSCJR-Departamenti i Çështjeve Jorezidente, Prishtinë, 2004; **15. Cikël me poezi "Udhë e zjarmi"**, në librin "Muzat i bien lyrës", Edicioni i revistës "Fidani", Prizren, 2005; **16. "Lulëkuqet e Vërrinit"**, poezi, botoi shtëpia botuese "Metafora", Zvicër, 2005; Ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me të gjitha gazetat dhe revistat e kohës, si: "Rilindja", Zvicër - Prishtinë, "Bujku", Prishtinë, "Zëri i Kosovës", Zvicër - Prishtinë, "Bota sot", Zvicër, "Koha ditore", Prishtinë, "Epoka e re", Prishtinë, "Zëri", Prishtinë, "Fakti", Shkup, "Ars", Tiranë, "Pena shqiptare", Prishtinë, "Pionieri", Prishtinë, "Zogu i mëngjesit", Prishtinë, etj. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës në Prishtinë. Që nga 23 marsi 2002, është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Zvicrës (SSV). Jeton dhe vepron në Zvicër.

Libra të tjerë:

17. Zana në mërgim, poezi për fëmijë, "Metafora", Zvicër, 2006;

18. Huqet e Benit, poezi për fëmijë, "Metafora", Zvicër, 2006;

19. Bosi lepurushi, fabula, "Metafora", Zvicër, 2006;

20. Gjëgjeza, "Metafora", Zvicër, 2006;

21. Dita me Tonin (Poemë), "Metafora", Zvicër, 2006;

22. Muajt e vitit me Ardin (Poemë), "Metafora", Zvicër, 2006;

Që nga janari i vitit 2004, editon revistën "**Metafora poetike**", *Editorial i poetit që del në çdo tre muaj*.

Gëzim Ajgeraj
Dita me Tonin
Lektor: Ilam Berisha
Ilustrimet:
Radhitja kompjuterike: Artan Ajgeraj
14 faqe: 10,5 cm.
Tirazhi: 500
Të drejtat e rezervuara për autorin
GA 200603-03-21

Vargut të krijimeve të larmishme, të poetit, publicistit, dramaturgut, eseistit dhe shkrimtarit tashmë të njohur, Gëzim Ajgeraj, po i shtohet edhe një përmbledhje poetike për fëmijë, përkatësisht poema "Dita me Tonin". "Dita e mirë shihet që në mëngjes", thotë një fjalë e urtë. Bashkë me rrezet e çiltra të mëngjesit, ngrihet i gëzuar Toni. Dhe ashtu, me këngën në gojë, nën qiellin e përshkimeve ku tashmë, zogjtë fluturojnë të lirë, Toni do ta bëjë jetën ashtu siç është më së miri. Toni është i sjellshëm, ka dashuri ndaj prindërve, ndaj shokëve, ndërsa më tepër respekton nënën, ngase, shpeshherë ajo i ndihmon kur ka ndonjë detyrë pakëz si të vështirë. Dhe, dashuria bëhet reciproke. Nëna i thur këngë të birit duke i dëshiruar paqe e lumturi në jetë.

Duke lexuar përmbajtjen e kësaj poeme, të shkurtër, por kuptimplote, lehtë e kemi të kuptojmë se përmes Tonit shihet vetë simbolika e shpirtit të autorit, i cili, për mëmë-dhenë, jepet e tretet.

Përmes kësaj poeme, lexuesi mund të gjejë freskinë e çiltër të botës që e rrethon. Edhe një dëshmi është kjo e poetit Gëzim Ajgeraj, se në botën e fëmijëve sheh shpresën dhe vetëm me fuqizimin dhe optimizmin e njeriut të ri, mund të ndërtohet një ardhmëri e re.

Ilam Berisha, prof.